

## Kontrata e Terapisë

Ky dokument është i përgatitur dhe përpunuar nga OJQ Streha lidhur me të drejtat edhe detyrimet e pjesëmarrësit në terapi i cili pajtohet që t'i përmbushë gjatë gjithë kohës së terapisë në Strehë. Dokumenti në fjalë ka të bëjë me të drejtat personale të një pjesëmarrësi, si në vijim, ku përfshihen pikat të ndara në seksione dhe nënpika.

### A. Të Drejtat Personale:

1. Të drejtat e pjesëmarrësit si qytetar i Republikës së Kosovës.
  - 1.1. Pjesëmarrësi edhe pse është me terapi ka të drejtë të shpreh mendimin e vet personal.
  - 1.2. Gjithashtu nuk është i kufizuar në të drejtat e veta si qytetar i Kosovës.
  - 1.3. Po ashtu ka të drejtë edhe për të marrë përsipër obligimet e veta të cilat pjesëmarrësi i ka ndaj shtetit të Republikës së Kosovës.
2. Liria personale.
  - 2.1. Pjesëmarrësi pranon dhe respekton që liria personale në kohën e terapisë është e kufizuar.
  - 2.2. Është shumë e domosdoshme që secili të respektoj lirinë e njëri-tjetrit.
3. Vendosja (Sistemimi) në Strehë.
  - 3.1. Me të hyr në terapi pjesëmarrësi ka të drejtë për një dhomë të përbashkët me dikë tjetër për të fjetur, ushqim, pastrim personal dhe pastrim të rrobave.
    - 3.1.1. Fjetja, ushqimi dhe pastrim, të gjitha janë falas.
    - 3.1.2. Pra nuk është i detyruar ta kompenzoj me para.
    - 3.1.3. Si kompenzim pjesëmarrësi punon punë vullnetare si lloj kontributi për strehim.
    - 3.1.4. Për punën e kryer pjesëmarrësi pranon një shumë majft simbolike për ditë pune.
  - 3.2. Dhomën ku pjesëmarrësi vendoset mund ta pajisë/rregulloj sipas shijës së vet.
  - 3.3. Këtë gjë mund ta bëjë me marrëveshje me pjesëmarrësim tjetër që e ka në dhomë dhe kujdestarin e vet.
  - 3.4. Kur vjen një pjesëmarrës i ri, tjetri është i gatshëm të bëjë ndërrimin e dhomës.
  - 3.5. Ndërrimi i dhomës bëhet sipas nevojës.
4. Kontaktet me familjarët dhe të afërmit e ngushtë.
  - 4.1. Pjesëmarrësi ka të drejtë të mbajë kontakte me familjarët e vet.
    - 4.1.1. Vizita të familjarëve në STREHË (shih Rregulloren)
    - 4.1.2. Kontakte përmes telefonit
    - 4.1.3. Kontakte përmes letrave.
  - 4.2. Kur të vijë postieri të marrë apo të sjellë posten, kujdestari është i obliguar të informojë pjesëmarrësin.
  - 4.3. Letrat gjithmonë duhen të hapen në prani të kujdestarit personal.
  - 4.4. Pjesëmarrësi po ashtu ka të drejtë që nga kujdestari të informohet edhe për thirrje telefonike nga familjarët (Deri në ditën kur t'i lejohen telefonatat).
5. Gjërat personale.
  - 5.1. Me të hyr në terapi pjesëmarrësi dorëzon të gjitha paratë, dokumentat personale dhe gjërat që nuk lejohen në terapi.
  - 5.2. Këto gjëra personale i dorëzohen kujdestarit apo ndonjërit nga stafi në zyre.
  - 5.3. Këto gjëra personale ruhen në një vend të sigurtë deri në përfundimin e terapisë.

- 5.4. Pas përfundimit të terapisë, gjëra e sipërcekura i kthehen pjesëmarrësit.
  - 5.5. Pjesëmarrësi ka të drejtë që paratë e dorëzuara tek kujdestari apo tek stafi i STREHËS t'i shfrytëzoj sipas nevojës, mirëpo vetëm nën mbikqyrjen e stafit.
6. Këshillimi i nevojshëm/domosdoshëm.
    - 6.1. Pjesëmarrësi ka të drejtë të ketë këshillim adekuat sipas nevojës.
    - 6.2. Ky lloj këshillimi mund të jetë nga jashtë.
      - 6.2.1. Këshillim nga mjeku.
      - 6.2.2. Këshillim nga psikologu.
  7. Ruajtja/Ndarja e informacioneve e të tjerëve.
    - 7.1. Pjesëmarrësi detyrohet, që informacionet personale të tjetrit t'i trajtoj me besim dhe t'i mbaj sekret.
    - 7.2. Informacionet e një pjesëmarrësit nuk lejohet të ndahen me të tjerët.
    - 7.3. Informacionet e të tjerëve nuk lejohet të bartën me vete as edhe jashtë terapisë.
    - 7.4. E njëjta gjë vazhdon të jetë valide edhe kur pjesëmarrësi ta ketë kryer terpinë.
  8. Sëmundjet eventuale të veçanta.
    - 8.1. Njoftimi i tjerëve për ndonjë sëmundje eventuale të veçantë është i mirëseardhur.
    - 8.2. Mirëpo jo edhe i detyrueshëm.
    - 8.3. Kjo gjë varet nga vet pjesëmarrësi.
    - 8.4. Kjo bëhet me qëllim që gjërat të kuptohen më mirë edhe për të pasur kujdes ndaj njëri-tjetrit.
  9. Daljet jashtë qendrës gjatë terapisë.
    - 9.1. Deri në fazën e fundit të terapisë pjesëmarrësi nuk ka të drejtë dalje nga qendra pa përcjellës.
    - 9.2. Dalja nuk lejohet as për të vizituar familjarët ose shokët e ngushtë.
    - 9.3. Pjesëmarrësit i lejohet të dal pa përcjellje, për një kohë të caktuar, vetëm në këto raste:
      - 9.3.1. Dasma në rrethin e ngushtë familjar.
      - 9.3.2. Vdekje në familje (rrethi i ngushtë dhe i gjërë).
      - 9.3.3. Lindja e fëmiut.
    - 9.4. Vetëm në fazën e fundit të terapisë (faza e integritimit) pjesëmarrësi ka të drejtë të dal jashtë qendrës sipas vendimit të stafit.

## B. Sjellja dhe Qëndrimi i Duhur dhe Integrimi në Terapi

1. Pajtimi i domosdoshëm me rregullat e shtëpisë
  - 1.1. Me të hyr në terapi pjesëmarrësi pajtohet me **rregullat e shtëpisë**.
  - 1.2. Pjesëmarrësi plotësisht shmanget nga droga (përveç nëse është në programin e detoksimit ku përdorën medikamente lehtësuese për tje kalimin e krizave) dhe alkooli.
    - 1.2.1. Kur krijohen dyshime se pjesëmarrësi shkelë këtë pikë, duhet të ketë gatishmërinë t'i nënshtrohem një testi.
    - 1.2.2. Refuzimi eventual i testit llogaritet baras me rezultatin pozitiv të testit.
2. Pirja e duhanit gjatë terapisë.
  - 2.1. Pjesëmarrësi pajtohet të zvogëloj numrin e cigareve në ditë.
    - 2.1.1. Pesë (5) cigare në ditë gjatë muajit të parë të qëndrimit.
    - 2.1.2. Nga muaji i dytë vetëm 3 cigare në ditë.
  - 2.2. Cigarja nuk lejohet të pihet brenda shtëpisë.
  - 2.3. Cigarja pihet vetëm jashtë shtëpisë, në vendin e caktuar nga stafi.
  - 2.4. Për sigurimin e cigareve përgjegjës është vet pjesëmarrësi.

3. Heqja dorë dhe kufizimet.
  - 3.1. Pjesëmarrësi heq dorë për të nisur një marrëdhënie-dashurie në kohën e terapisë.
  - 3.2. Kjo bëhet për shkak se një lidhje e tillë mund të ndikoj negativisht në procesin terapeutik.
  - 3.3. Poashtu e ka të ndalur rreptësisht marrëdhënie-dashurie me personat që janë në staf të organizatës.
4. Pajtimet e pjesëmarrësit me Qendrën STREHA
  - 4.1. Pjesëmarrësi ka gatishmërinë për tu pajtuar me urdhërat nga ana e stafit.
    - 4.1.1. Me urdhërat që nuk bie dakord ka të drejtë të kërkoj sqarim plotësues nga ana e stafit udhëheqës.
  - 4.2. Pjesëmarrësi pajtohet që secili punëtor i stafit punues ka të drejtë për kontrollim dhe inspektim të dhomës se tij në çdo kohë.
  - 4.3. Pjesëmarrësi pajtohet që secili punëtor i stafit punues ka të drejtë për të bërë kontrolla personale në çdo kohë qoftë si rutine ose në rast dyshimit (d.m.th. me kontrollu teshat, çantat,...).
  - 4.4. Në biseda personale si edhe në grupe, sjellja e pjesëmarrësit duhet të jetë kooperative.
  - 4.5. Pjesëmarrësi ka gatishmërinë që të jap llogari tek kujdestari i tij personal (hap veten). Kjo vlen edhe për të kaluarën e tij.
  - 4.6. Pjesëmarrësi pajtohet që kujdestari personal ka të drejtë për të marrë informata rreth tij.
    - 4.6.1. Informatat mirren tek familjarët e tij.
    - 4.6.2. Rrethi i tij i ngusht.
    - 4.6.3. Mjeku ose institucionet e ndryshme.
    - 4.6.4. Bashkëpunimi ndërmjet Strehës dhe rrethit të ngusht është pjesa e terapisë.
  - 4.7. Pjesëmarrësi detyrohet të jetë i përpiktë në program të organizatës dhe pajtohet që pjesëmarrja tij në program është e obliguar.

### C. Sjellja dhe Etika

1. Qëndrimi dhe sjellja e pjesëmarrësit.
  - 1.1. Pjesëmarrësi nuk e përdori dhunën dhe në rast se nuk është i kënaqur ndonjëherë.
  - 1.2. Pjesëmarrësi do të kërkoj bashkëbisedim.
  - 1.3. Kur dikush bën thirrje për konsultim ose bisedë, pjesëmarrësi është i gatshëm që sa me parë të paraqitet për të bashkëbiseduar.
  - 1.4. Pjesëmarrësi ka të drejtë që kujdestari i tij të jetë prezent në çdo konsultim me punëtorët e stafit dhe të jetë i gatshëm të dëgjoj mendimin e tij.
2. Pjesëmarrësi detyrohet që të mos marrë pjesë asnjëherë në organizimin e gjërave, të çfarëdo natyre qofshin ato, që ndikojnë negativisht.
  - 2.1. Qoftë ky lloj organizimi nga grupi i pjesëmarrësëve/pacientëve.
  - 2.2. Qoftë ky lloj organizimi nga ndonjë individ i caktuar që planifikon diçka kundër njëri-tjetrit, stafit punues ose interesave të organizatës.
3. Pjesëmarrësi ka gatishmërinë të jetë i sinqertë ndaj vetvetës, ndaj stafit dhe pjesëmarrësve të tjerë.
4. Si burrë pjesëmarrësi obligohet të ketë një mirë-sjellje.
  - 4.1. Sjellja korrekte ndaj gjinisë se kundër.
  - 4.2. Sjellja korrekte ndaj bashkëshortës së stafit.
  - 4.3. Sjellja korrekte ndaj fëmijëve të stafit.
  - 4.4. Sjellja korrekte edhe ndaj rrethanave të tjera të krijuara.

5. Pjesëmarrësi repsekton urdhërat dhe korrektsitë e prindërve të tyre (fëmijëve) në raport me atë.
  - 5.1. Nuk ndikon negativisht në trajtimin e tyre (fëmijëve).
  - 5.2. Nuk fton asnjë fëmijë asnjëherë në dhomën vet.
  - 5.3. Nuk do të jetë vetëm për vetëm në shoqërim me një të mitur (fëmiu).

#### D. E Drejta për Informacion dhe Ankesë

1. Pjesëmarrësi sigurohet që informacionet e tij personale nuk do të dalin tek personat e tjerë të terapisë apo jashtë qendrës.
  - 1.1. Përveç në rast se ai pajtohet ndryshe.
  - 1.2. Me përjashtim të organeve shtetërore.
2. Kur pjesëmarrësi ka ankesa është i detyruar që ta njoftoj drejtorin e terapisë përpara se të ndërmarr hapa të tjerë.
3. Në qoftë se nuk mund të arrihet një konkluzion, pjesëmarrësi ka të drejtë ankese me shkrim tek **Ombudsperson (Avokati i Popullit)** në Prishtinë ose në Gjilan.

#### E. Ndërprerja e Terapisë:

1. Në qoftë se pjesëmarrësit filozofia e terapisë nuk i duket e përshtatur, ia ka të drejtë në çdo kohë të ndërprejë terapinë.
2. Kur ndërpritet terapia pjesëmarrësi ka të drejtë të marrë gjërat personale të cilat i ka dorëzuar në fillim të terapisë (paratë, dokumentet).
3. Kur largohet nga terapia në mënyrë të parregullt.
  - 3.1. Dhoma e tij brenda pesë ditëve do të pastrohet.
  - 3.2. Gjërat e tij personale ruhen për tridhjetë ditë nga dita e largimit.
  - 3.3. Brenda këtij afati pjesëmarrësi ka të drejtë që t'i marrë gjërat e tij apo dikush tjetër me autorizim.
  - 3.4. Në qoftë se kalon ky afat, atëherë gjërat e pjesëmarrësit kalojnë në pronësi të qendrës.
4. E drejta e kthimit në terapi.
  - 4.1. Kur pjesëmarrësi është i gatshëm të mbartë pasojat pasi që ka ndërprerë terapinë.
  - 4.2. Kur pajtohet se terapinë do ta filloj nga e para.
  - 4.3. Kur shihet seriozitet dhe gatishmëri për kthim prap në terapi.

#### F. Arsyet për Largim nga Terapia:

1. Kur një pjesëmarrës largohet nga terapia.
  - 1.1. Atëherë kur sjell drogë, alkool apo medikamente të pa lejuara.
    - 1.1.1. Pjesëmarrësi përjashtohet brenda ditës nga terapia.
    - 1.1.2. Në të njëjtën mënyrë edhe kush përdorë dhunë.
  - 1.2. Kërcënimet nuk janë të toleruara.
    - 1.2.1. Ka mundësi që edhe ato të qojnë deri në përjashtim nga terapia.
    - 1.2.2. Përjashtimi mund të jetë i menjëhershëm.
  - 1.3. Kush e bezdis gjininë femrore.
  - 1.4. Kushdo që ngacmon tjetrin në qendër përjashtohet nga terapia.

2. Nëse dikush për disa herë shkelë rregullat e shtëpisë.
  - 2.1. Nuk tregon gatishmërinë për një bashkëpunim konstruktiv.
  - 2.2. Përrjashtohet pas bisedave kur ato nuk sjellin ndryshim.
3. Përpjekjet suicide (për vetvrasje) sqarohen nga ana mjeksore dhe transferohen në kliniken psikiatrike nëse është e nevojshme.
  - 3.1. Kur ka kërcënime me suicid (për vetvrasje) plotësohet kontrata e suicides.
  - 3.2. Në qoftë se personi nuk tregon gatishmërinë për këtë përjashtohet nga terapia.

#### **G. Fryma e Terapisë:**

1. Terapia zhvillohet në parime biblike.
2. Për këtë pikë pjesëmarrësi është i informuar para hyrjes në terapi.
3. Pjesëmarrësi pajtohet me këtë filozofi.
4. Terapia zhvillohet në mënyrë vullnetare dhe pjesëmarrësi konfirmon se në terapi është me vet dëshirë.

#### **H. Sigurimi:**

1. Pjesëmarrësi është i informuar që STREHA nuk merr përsipër asnjëlloj sigurimi shëndetësor apo sigurim personal.
2. Në rast se pjesëmarrësi pëson ndonjë aksident apo lëndim trupor ose sëmuret, pjesëmarrësi përgjigjet për vetëvetën.
3. Pjesëmarrësi është i informuar se në qoftë se ka dëshirë për të pasur një sigurim shëndetësor, personal a çfarëdo lloj sigurimi tjetër, kjo duhet të organizohet nga vetë ai dhe nga financat e tij.

#### **I. Kohëzgjatja e Terapisë:**

1. Kohëzgjatja e terapisë rregullohet:
  - 1.1. Në menyrë individuale.
  - 1.2. Nuk ka të drejtë krahasimi me pjesëmarrës tjerë në program.
  - 1.3. Terapia zhvillohet bazuar në përparimin dhe përmirësimin e pejsëmarrësit individualisht.

#### **J. Kontributi Financiar për Terapinë:**

1. Terapia është **falas**.
2. Barna të veçanta që i nevojiten një pjesëmarrësi duhet të siguroj nga vet ai.
3. Gjithashtu edhe teshat apo gjërat higjenike.
4. Për punën e bërë brenda STREHËS pjesëmarrësi paguhet me një shumë simbolike shumë të vogël pas një kohe të caktuar (shih Rregulloren e Strehës).
5. Për punën e bërë brenda STREHËS, pjesëmarrësi nuk paguhet dhe nuk ka të drjetë kompenzimi të më vonshëm.

## Konkluzion

1. Unë konfirmoj që këtë dokument e kam lexuar me kujdes në plotësi dhe e kam kuptuar.
2. Jam dakord me të gjitha pikat prej **A** deri në **J** dhe me nënpikat.
3. Me nënshkrimin tim konfirmoj që jam në terapi në mënyrë vullnetare dhe marr përsipër përgjegjësinë për vetëvetën.
4. Konfirmoj se familja ime dhe personat tjerë përkatës kanë njohuri për këtë kontratë dhe pajtohen në të njëjtën mënyrë sikur se unë.
5. Unë pajtohem se në rast se terapia ndërpritet, në raste aksidenti apo suicide, STREHA nuk obligohet (nuk mbahet përgjegjëse) për asgjë si nga ana e organeve përkatëse edhe as nga ana e famijes.

Livoç i Epërm

Datë: \_\_\_\_\_

Pjesëmarrësi: \_\_\_\_\_

STREHA: \_\_\_\_\_